



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 31 gusht 2015
Nr. ref.: RK 831/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI11/15

Parashtrues

Ymer Bardhi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të
Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-I.-14-0233,
të 1 dhjetorit 2014**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Ymer Bardhi me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit), AC-I.-14-0233, të 1 dhjetorit 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar. Parashtruesi i kërkesës nuk ka cekur në mënyrë specifike se cilat nene të Kushtetutës janë shkelur.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 4 shkurt 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 12 mars 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI11/15, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI11/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.
7. Më 28 prill 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Kolegjit të Apelit.
8. Më 1 korrik 2015, me Vendimin GJR. KI11/15, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Arta Rama-Harjizi anëtare të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Enver Hasani, të cilit i përfundoi mandati në Gjykatën Kushtetuese më 26 qershor 2015.
9. Më 7 korrik 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, prona e patundshme në pronësi të paraardhësve të tij ishte marrë pa të drejtë në vitin 1946 dhe u ishte ndarë personave të tjerë. Personat e përmendur, në një datë të pacaktuar, ia shitën tokën kontestuese ndërmarrjes shoqërore „BUJQËSIA“ nga Peja.
11. Në shtator 2013, parashtruesi i kërkesës ka iniciuar procedurën para Trupit gjykues të DHPGJS-së, në të cilën kërkoi anulimin e kontratës së lartpërmendur të shitblerjes, me të cilën ndërmarrja shoqërore „BUJQËSIA“

nga Peja, tani nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP), është bërë pronare e patundshmërisë kontestuese. Përveç kësaj, parashtruesi kërkoi nga Trupi gjykues i DHPGJS-së edhe vendosjen e masës së përkohshme të ndalimit të tjetërsimit të patundshmërisë së përmendur nën administrimin e AKP-së.

12. Më 22 korrik 2014, Trupi gjykues i DHPGJS-së [me Vendimin C-III.-13-0462] aprovoi kërkesën e parashtruesit për vendosjen e masës së përkohshme të ndalimit të tjetërsimit të patundshmërisë së përmendur nën administrimin e AKP-së, deri në marrjen e vendimit përfundimtar mbi bazueshmërinë e lëndës.
13. Më 31 korrik 2014, AKP-ja paraqiti ankesë ndaj Vendimit të Trupit gjykues të DHPGJS-së në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së, duke pretenduar se parashtruesi i kërkesës që nga viti 1952 dhe këndej nuk ka qenë asnjëherë titullar juridik i patundshmërisë kontestuese. Sipas nenit 268 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar, kthimi i pronësisë mund të kërkohet në afat prej 5 (pesë) vjetësh, duke filluar nga dita e marrjes në dijeni, e më së voni në afat prej 10 (dhjetë) vjetësh.
14. Më 25 nëntor 2014, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së [me Vendimin AC-I.-14-0233] aprovoi ankesën e AKP-së dhe anuloi Vendimin [C-III.-13-0462] e Trupit gjykues të DHPGJS-së, si dhe refuzoi kërkesën e parashtruesit për vendosjen e masës së përkohshme. Në arsyetimin e vendimit të tij, Kolegji i Apelit i DHPGJS, ndër të tjera, theksoi:

„Pretendimi i parashtruesit të kërkesës se ai e mban/shfrytëzon pronën me qëllim të mirë nuk është argument juridik për lëshimin e masës së përkohshme.

Për arsyet e lartcekura, Kolegji i Apelit e anulon vendimin e kontestuar dhe refuzon kërkesën e parashtruesit për lëshimin e masës së përkohshme si të pabazuar.

Ky vendim nuk ka asnjë ndikim në zgjidhjen përfundimtare të kësaj kërkesë, përkundrazi, parashtruesit e kërkesës inkurajohen që të ofrojnë dëshmi në procedurë për t'i mbështetur pretendimet e tyre ndaj pronës.”

Dispozitat relevante ligjore

Ligji mbi Punën e Bashkuar

PR nr. 528

i 25 nëntorit 1976

Neni 268

*Nëse patundshmëria është bërë mjet shoqëror pa bazë juridike, kthimi i së njëjtës mund të kërkohet në afat prej pesë vjetësh, duke filluar nga dita e marrjes në dijeni, e më së voni në afat prej dhjetë vjetësh.
[...].*

Pretendimet e parashtruesit

15. Parashtruesi i kërkesës konsideron se Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, me Aktvendimin e tij AC-I.-14-0233-A0001, të 1 dhjetorit 2014, e ka anuluar Aktvendimin e Trupit gjykues të DHPGJS-së me arsyetim të paqëndrueshëm.

16. Parashtruesi i kërkesës më tej thekson:

„Se Kolegji i Apelit i DHOMËS SË POSAÇME të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës në Prishtinë, me aktvendimin e tij, numër dhe datë apostrofuar më sipër, në kundërshtim me çdo normë dhe rregull juridik rrjedhimisht ka prejjudikuar zgjidhjen përfundimtare të padisë së paditësve...”.

17. Parashtruesi kërkon nga Gjykata, si në vijim:

*„Aktvendimi i Kolegjit të Apelit të DHOMËS SË POSAÇME të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës në Prishtinë, AC-I.-14-0233-A0001 dt. 01.12.2014, **anulohet**, ndërsa aktvendimi i Kolegjit të Specializuar të DHOMËS SË POSAÇME të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës në Prishtinë, C-III.-13-0462 dt. 20 korrik 2014, lidhur me **CAKTIMIN E MASËS SË PËRKOHSHME TË SIGURISË** në barrë të patundshmërisë kontestuese evidentuar në Certifikatën Nr. 01-30-13, Zona Kadastrale LUTOGLLAVË, Komuna Kadastrale Pejë, **mbetet edhe më tej në fuqi deri në zgjidhjen meritore të padisë – datë 17 shtator 2013.**”*

Pranueshmëria e kërkesës

18. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

19. Në këtë kuptim, Gjykata i referohet nenit 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

„1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

20. Gjykata thekson se kërkesa e parashtruesit shqyrtohet nga aspekti i shkeljes së të drejtave dhe të lirive të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ. Megjithatë, Gjykata vëren se parashtruesi, në kërkesën e tij, përveç bazës juridike për parashtrimin e kërkesës, nuk ka përmendur konkretisht se cilat të

drejta dhe liri të garantuara me Kushtetutë janë shkelur me vendimin të cilin ai e konteston, edhe pse me nenin 48 të Ligjit parashihet:

„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

21. Gjykata gjithashtu merr parasysh edhe rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) të Rregullores së punës, të cilat përcaktojnë:

“(1) Gjykata mund të shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi e pabazuar, nëse bindet se:

(a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose

(b) aktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose

(c) Gjykata gjen që parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë; ose

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

22. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së është në kundërshtim me çdo normë dhe rregull juridik.
23. Në këtë kuptim, Gjykata konsideron se Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, në vendimin e tij, ka ofruar arsye të vlefshme për gjetjet e tij (Shih paragrafin 12). Rrjedhimisht, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së e ka arsyetuar vendimin e vet dhe ka argumentuar pretendimin e parashtruesit të kërkesës në lidhje me refuzimin e kërkesës për lëshimin e masës së përkohshme, duke arsyetuar që *“pretendimi se ata kanë qenë shfrytëzues me mirëbesim të kësaj prone, nuk është argument ligjor për lëshimin e masës së përkohshme”*.
24. Për më tepër, Kolegji i Apelit më tej theksoi: *“Ky aktvendim nuk prejjudikon zgjidhjen përfundimtare të kësaj padie në asnjë mënyrë. Përkundrazi, inkurajohen paditësit që të ofrojnë prova në procedurë, që do të dëshmojnë pretendimet e tyre pronësore”*.
25. Gjykata rithekson që nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, në lidhje me vendimet që merren nga DHPGJS. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. Detyrë e Gjykatës Kushtetuese është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta ishin të drejta në tërësi, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave (Shih rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Nr.*

13071/87, Raport i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991).

26. Në këtë rast, Gjykata nuk gjen se procedurat përkatëse para DHPGJS-së kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, Vendim i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).
27. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur pretendimin e tij në baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar prova që tregojnë se si dhe pse të drejtat dhe liritë e tij, të garantuara me Kushtetutë, janë shkelur me vendimin e kontestuar për refuzimin e kërkesës për vendosjen e masës së përkohshme.
28. Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 31 gusht 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve dhe ta publikojë këtë Vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 paragrafi 4 të Ligjit; dhe
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Snezhana Botusharova



Artur Rama-Hajrizi